



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

**VENDIM**

**Nr. 13, dt.08.01.2016**

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.01.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për *Prof. Dr. Hasan Nallbani*,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë **B. “Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”**, me nënkategorinë **B/1, B/3**, sipas rregullore “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të *Prof. Dr. Hasan Nallbani*.
  2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e *Prof. Dr. Hasan Nallbani*, me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë **B. “Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”**, me nënkategorinë **B/1, B/3**.
  3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**